



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E KULTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE**

Nr. 553 prot.

Tiranë, më 18 / 02 / 2018

M E M O

LËNDA: Informacion për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores së Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare.

Drejtuar: **Znj. Mirela KUMBARO FURXHI, Ministër**
Z. Oltjon Muzaka, Sekretar i Përgjithshëm

Miratoi: **Znj. Risena Xhaja, Drejtor i Përgjithshëm**

Pranoi: **Znj. Elira Dani, Përgjegjës Sektori**

Konceptoi: **Z. Mishel Skrapalliu, Specialist**

I nderuar z. Muzaka,

Me shkresën nr. 75, datë 24.04.2017 Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike ka paraqitur në Ministrinë e Kulturës për miratim Statutin e QKVF-së dhe projekt-rregulloren e Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare.

Gjatë vitit 2017 Drejtoria Juridike dhe Marrëveshjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Trashëgimisë Jo materiale dhe QKVF-në hartoi Statutin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike cila është miratuar me urdhrin nr. 220, datë 04.05.2017.

Pas miratimit të Statutit të QKVF-së, Drejtoria e Programimit e Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim me QKVF-në, dhe Drejtorinë e Zhvillimit të Programeve të Kulturës hartuan dhe bashkërenduan projekt rregulloren e festivaleve folklorike Tipologjike Kombëtare.

Kjo kërkesë vjen nga QKVF-së si pasojë e ndryshimeve strukturore në sistemin e institucioneve të kulturës, përjasjes me zgjerimin e politikave të ndërmarra në fushën e

trashëgimisë jo materiale si dhe rekomandimeve të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, të lëna në këtë institucion me shkresën nr. 2178/6, datë 04.05.2017.

Kjo rregullore është bazuar në vendimin nr. 595, datë 29.12.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e shpalljes së konkurseve me karakter kombëtar, lokal dhe dhënien e çmimeve për to”, i ndryshuar. Miratimi i kësaj rregulloreje do të sjell menaxhim më të mirë të aktiviteteve folklorike që organizohen nga QKVF-ja ku është parashikuar dhe programi “Edukimi i brezave përmes kulturës” dhe aktivitete të tjera që nuk kanë pas qenë përfshirë në rregulloren ekzistuese e miratuar që në vitin 2008. Më konkretisht risitë që janë përfshirë në përmbajtje të saj janë :

1. Përfshirja e rregullimeve përkatëse në kuadër të programit “Edukimi përmes Artit dhe Kulturës” (neni 5);
2. Përmirësimi dhe përshtatja e kriterëve të reja, për organizimin e aktiviteteve folklorike tipologjike në të gjithë vendin;
3. Përmirësimi i strukturës organizative të Festivaleve të përshtatura me politikën e MK-së;
4. Përcaktimi dhe ndarja e burimeve të financimit të festivaleve në raportet 50%-pushtet qendror (QKVF) dhe 50%-pushtet vendor (bashkia ku organizohet festivali). Ma parë ka qenë evazive pasi nuk ka pasur një rregullim të tillë;
5. Ndarja dhe dhënia e çmimeve sipas vlerësimit të figurave dhe kontributeve të dhëna nga artistët në këtë fushë;

Nisur sa më sipër, bashkëlidhur gjeni për nënshkrim projekttrudhrin përkatës.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. 55/4 prot

Tiranë, më 18 / 02 /2018

URDHËR

Nr. 108, Datë 18 / 02 /2018

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË FESTIVALEVE FOLKLORIKE TIPOLOGJIKE
KOMBËTARE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe vendimit nr. 595, datë 29.12.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e shpalljes së konkurseve me karakter kombëtar, lokal dhe dhënien e çmimeve për to”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores së Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Urdhri nr. 932, datë 23.10.2008 “Për miratimin e rregullores së Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike për zbatimin e këtij urdhri, dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve të Kulturës, për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Mirela KUMBARO-FURXHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE FOLKLORIKE

MIRATOHET

MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI



RREGULLORE E FESTIVALEVE FOLKLORIKE TIPOLOGJIKE KOMBËTARE

2018

RREGULLORE E FESTIVALEVE FOLKLORIKE TIPOLOGJIKE KOMBËTARE

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Festivalet Folklorike Tipologjike Kombëtare

Festivalet Folklorike Tipologjike Kombëtare shpallen nga Ministria e Kulturës. Ato janë:

- a) “Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Sazeve” në qytetin e Korçës;
- b) “Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë” në qytetin e Lezhës;
- c) “Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Këngës Popullore Qytetare” në Elbasan më 11-13 mars me rastin e festës së Ditës së Verës;
- d) “Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore”, në qytetin e Lushnjës.
- e) “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-polifonisë”, në qytetin e Vlorës më 23-25 nëntor, me rastin e nominimit të Iso-Polifonisë në UNESCO;
- f) “Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Riteve dhe Lojrave Popullore”
- g) “Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Talenteve të reja të Folkut Shqiptar” (këngë, valle, instrument, lojra, rite deri në 15-vjeç), në bashkëpunim edhe me AKVP, në muajin maj në Petrele, Preze apo Kalanë e Krujës;
- h) “Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore-Artistike”, në muajin shtator në Kalanë e qytetit të Beratit, duke u koordinuar me FFK të Gjirokastrës, njëherë në dy vjet apo tre vjet.

Neni 2

Qëllimi i Festivaleve Kombëtare Tipologjike

- 1. Festivalet Folklorike Tipologjike Kombëtare (ketej e tutje FFTK), organizohen nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe Qendrat e Artit pranë tyre, shoqatat kulturore artistike, individë të interesuar etj.
- 2. Këto Festivale zhvillohen një herë në 2 vjet në qytetin përkatës.

Neni 3

Vendi i organizimit

- 1. Qyteti i Veprimtarive Folklorike propozohet nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike (këtej e tutje QKVF) dhe miratohet nga Ministri i Kulturës.

2. Këto veprimtari të rëndësishme kombëtare mund të ndryshojnë qytetin organizator dhe datat, vetëm kur pushteti vendor nuk përgjigjet nga ana administrative dhe financiare kërkesave për organizimin sa më cilësor të tyre në bashkëpunim me QKVF. QKVF informon Ministrinë e Kulturës për mangësitë e mos organizimit në qytetin përkatës dhe masat që merr përsipër qyteti i propozuar si organizator.
3. Në çdo fund viti QKVF, në bashkëpunim paraprak me pushtetin vendor, paraqet për miratim në Këshilli Kombëtar Trashëgimisë Kombëtare Jomateriale (ketej e tutje KKTKJ) pranë Ministrisë së Kulturës, qytetet organizatore dhe kohën e zhvillimit të veprimtarive kombëtare të vitit të ardhshëm.

Neni 4

Organizimi

1. FFTK organizohen në zbatim të politikës kulturore të Ministrisë së Kulturës, në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale në kuadër edhe të veprimtarive të turizmit kulturor. Ato promovojnë dhe nxisin krijimtarinë muzikore popullore, interpretimin dhe ekzekutimin e saj. FFTK i “Sazeve”, i “Rapsodëve dhe Instrumentistëve”, i “Këngës Qytetare Shqiptare”, i “Valles Popullore” i “Iso – Polifonisë Popullore”, i “Riteve dhe Lojrave Popullore” i dhe “Talenteve të Reja të Folkut Shqiptar”.
2. FFTK kanë për qëllim ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe propogandimin e vlerave më të mira të folklorit dhe traditës në Republikën e Shqipërisë dhe të trashëgimisë jomateriale folklorike që ruhet e zhvillohet në trojet shqiptare jashtë kufijve shtetërorë si në Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Greqi dhe Diasporë, të formave dhe gjinive të tij siç janë: këngët, meloditë, interpretimi me instrumenta popullorë, vallja popullore, veshjet e traditës, zejet tradicionale, lojrat popullore, ritet etj.
3. FFTK mund të organizohen si manifestime kulturore artistike edhe në qendra historike, kala apo sheshet e qyteteve organizative.

Neni 5

Edukimi përmes kulturës

1. QKVF propozon organizimin e veprimtarive të ndryshme për popullarizimin e traditës tek brezat e rinj.
2. Në kuadër të nismës së Ministrisë së Kulturës për edukimin përmes artit dhe kulturës, në çdo FFTK pushteti vendor i qytetit organizator përgatit për pjesëmarrje, si të ftuar, bazuar tipologjisë së veprimtarisë, një grup artistik me të rinj, nga Qendra Kombëtare Kulturore të Fëmijëve, nga shkollat 9-vjeçare apo të mesme.

Neni 6

Veprimtaritë multikulturore

1. Çdo FFTK zhvillohet si veprimtari multikulturore ku përveç shfaqjeve konkurruese zhvillohen edhe veprimtari të tjera si:
 - a) shfaqje në zonat rreth Bashkisë përkatëse;
 - b) panairë të artizanatit, të kulinarisë dhe prodhimeve të zonës,
 - c) konferenca shkencore;
 - d) tryeza të rrumbullakta me temë folklorin dhe interpretimin e tij;
 - e) vizita në monumentet e trashëgimisë kulturore në gjithë zonën.
2. Këto veprimtari kombëtare organizohen me pushtetin vendor dhe shërbejnë për zhvillimin e turizmit kulturor, gjallërimin e biznesit vendas dhe në shtimin e vizitorëve vendas e të huaj.

Neni 7

Ekskluziviteti

1. Ministria e Kulturës dhe QKVF kanë ekskluzivitetin e organizimit të FFTK-ve, si dhe në drejtim të prodhimit të filmimeve, incizimeve, botimeve muzikore, CD-ve, DVD-ve, etj të FFTK-ve.

II. PJESEMARRJA NË FESTIVALET FOLKLORIKE TIPOLOGJIKE

KOMBËTARE

Neni 8

Pjesmarrja

1. Në FFTK kanë të drejtë të paraqiten individë të lirë (këngëtarë, valltarë dhe instrumentistë popullorë), grupe të shoqatave folklorike (grupe vokale, instrumentale etj) grupe folklorike të Qendrave Kulturore (Qendrat e Artit) pranë bashkive të cilat mbartin në vetvete vlera origjinale të folklorit shqiptar.
2. QKVF dhe komisionet përzgjedhëse kanë prioritet pjesëmarrjen e të rinjve në FFTK.

Neni 9

Kriteret

1. Pjesëmarrja e individëve, grupeve të shoqatave folklorike dhe qendrave kulturore pranë Bashkive bëhet me përzgjedhje, që kryhet nga ana e komisioneve të specialistëve të kualifikuar e me përvojë që caktohen nga QKVF.

2. Kriteret shkencore dhe artistike të përzgjedhjes përcaktohen zyrtarisht nga ana e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe QKVF, dhe miratohen në Komitetin Organizativ të FFTK. Ato janë të detyrueshme për zbatim nga ana e komisionit të specialistëve. Këto kritere shpallen 1 vit ose 6 muaj përpara zhvillimit të veprimtarisë nga QKVF .

III. PERZGJEDHJA E PJESËMARRJES NË FFTK

Neni 10

Komisioni Perzgjedhes

1. Komisioni Përzgjedhës përbëhet nga (3)tre deri në (5)pesë anëtarë, specialistë të fushave të etnomuzikologjisë, etnokoreografisë, veshjeve popullore dhe folklorit gojor, si dhe specialist të QKVF.

Neni 11

Shpalljet

1. Në çdo muaj janar, në ëeb-in e QKVF shpallen FFTK-të që do të zhvillohen si dhe njoftohen me shkresa qarqet, bashkitë, Qendrat Kulturore, Shoqatat Kulturore, individë të interesuar, së bashku me kriteret shkencore dhe organizative.

Neni 12

Përzgjedhja

1. Çdo grup pjesmarrës dërgon brenda 1 muaji nga fillimi i veprimtarisë, CD të grupit të ftuar. Nga këto CD, Komisioni Përzgjedhës, përzgjedh grupet më të mira për pjesmarrje. Në rast mungese të CD-së, Komisioni Përzgjedhës udhëton drejt qytetit të ftuar, për të përzgjedhur materialet më të mira.
2. QKVF njofton Grupet fituese për datat e pjesëmarrjes, kohën e koncertit, etj. Kjo procedurë përdoret edhe për grupet pjesëmarrëse nga Kosova, shqiptarët nga Mali i Zi, Maqedonia, arbëreshë të Italisë, etj.

Neni 13

Te ftuarit

1. Pjesëmarrja e të ftuarve nga jashtë vendit (si bartës folklori, grupe apo ansamble folklorike, studiues etnomuzikologë, folkloristë, etj.), propozohen nga QKVF dhe miratohen nga Komiteti Organizativ i FFTK.

IV. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 14

Struktura e FFTK

1. FFTK kanë organet e veta drejtuese, menaxhuese dhe vlerësuese:

- a) Komiteti Organizator;
- b) Juria e FFTK-së;
- c) Komisioni përzgjedhës;

Neni 15

Komiteti Organizativ

1. Komiteti Organizativ përbëhet nga 7 anëtarë me përbërje si më poshtë:

- a) Drejtori i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike,
- b) një përfaqësues i Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale pranë MK;
- c) Drejtori i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike;
- d) Kryetari i Bashkisë së qytetit organizator;
- e) Drejtori i Qendrës Artit të qytetit organizator,
- f) Drejtori i AKKVP,
- g) një Specialist nga QKVF.

2. Drejtori i QKVF-së kryen funksionet e Kryetarit të Komitetit Organizativ. Sipas rastit do të ftohen edhe specialistë të shquar të fushës.

Neni 16

Juria

- 1. Juria e Festivaleve Folklorike Tipologjike Kombëtare përbëhet nga (3) tre deri në (5) pesë anëtarë dhe shpallen ditën e çeljes së FFTK.
- 2. Në juri caktohen personalitete të njohur të fushës, studiues të folklorit, etnomuzikologë, etnokoreologë, etnografë, etj.
- 3. Juria propozohet nga QKVF-ja dhe miratohet nga Komiteti Organizativ i FFTK. Kryetari zgjidhet nga Juria në mbledhjen e parë të saj.

Neni 17

Kryetari i Komitetit Organizativ

1. Kryetari i Komitetit Organizativ, kryen detyrat si më poshtë:

- a) drejton, harmonizon dhe menaxhon veprimtarinë e të gjitha organizmave me përjashtim të Jurisë;
- b) paraqet zyrtarisht për njohje dhe aprovim projektin e çdo FFTK, kohën e zhvillimit të çdo festivali në qytetin përkatës, strukturën e ndërtimit të FFTK dhe preventivin përkatës pranë MK-së;
- c) në bashkëpunim me anëtarët e Komitetit përgatit strukturën e të gjithë veprimtarive të tjera që do të kryhen gjatë ditëve të festivalit dhe e paraqet atë për aprovim në Komitetin Organizativ;
- d) ndjek dhe nënshkruan gjithë korespondencën zyrtare përgatitore dhe gjatë zhvillimit të FFTK;
- e) drejton programin e konkurimit dhe progarmin e veprimtarive të tjera multikulturore si: Konferenca shtypi, tryeza të rumbullakëta, promovim librash të studiuesve apo krijuesve popullorë, ekspozita të zejeve tradicionale, panaire, etj;
- f) ndan detyrat e anëtarëve të Komitetit dhe kërkon realizimin e tyre në afat e cilësi;
- g) informon rregullisht MK për përgatitjen dhe zhvillimin e FFTK;
- h) dërgon zyrtarisht pranë MK, raportin përfundimtar lidhur me arritjet artistike, bashkëpunimin me pushtetin vendor përkatës si dhe problemet e organizimit, menaxhimit dhe zhvillimit të çdo FFTK.

Neni 18

Komiteti Organizator

1. Komiteti Organizator, kryen detyrat si më poshtë:

- a) propozon dhe menaxhon punën për fazën përgatitore, veprimtarinë e komisioneve përzgjedhëse, hartimin e programit të zhvillimit të FFTK, publicitetin në media, etj;
- b) në bashkëpunim me Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (pranë Qendrës Studimore Albanologjike), përcakton strukturën e konferencave shkencore dhe tryezat e rumbullakta dhe Kriteret Shkencore të FFTK;
- c) propozon realizimin me cilësi të spoteve, medaljonit (kupave), posterave, ftesave, dekorit të FFTK;
- d) në mbledhje të planifikuara periodike analizon, diskuton dhe vendos për mbarëvajtjen e punës për realizimin me sukses të FFTK;
- e) vendos për ofertën më të mirë të së drejtës televizive për FFTK, të ofruar nga televizionet kombëtare;

- f) vendos me shumicë vote për çështje të cilat kërkojnë votim.

V. QYTETI ORGANIZATOR I VEPRIMTARISË KOMBËTARE

Neni 19

Bashkëpunimi me pushtetin vendor

1. Financimi i FFTK do të jetë nga njësia vendore organizatore, nga QKVF si dhe nga sponsor dhe donatorë të ndryshëm.
2. Buxheti që do të përdoret për realizimin e këtyre aktiviteteve kombëtare ndahet 50 % nga pushteti vendor dhe 50 % nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike.
3. Çdo Bashki organizatore e FFTK, në bashkëpunim me QKVF, planifikon në buxhetin e saj të çdo viti financimin e FFTK në ditët kur do të organizohet kjo veprimtari kombëtare.
4. Pushteti vendor në bashkëpunim me QKVF dhe Komitetin Organizator, organizon punën për promovimin, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e FFTK, i sugjeron Komitetit mendime për mënyrën organizative të FFTK, merr masa për publicitetin e tij në media lokale, sistemimin e artistëve dhe stafit drejtues, vendin e shfaqjeve dhe të veprimtarive të tjera që do të zhvillohen gjatë ditëve të FFTK;
5. Kujdeset për lëvizjen dhe sistemimin e artistëve pjesëmarrës në FFTK dhe të ftuarve.

Neni 20

Detyrat e pushtetit vendor dhe qendrat e artit

1. Bashkitë dhe Qendrat e Artit, angazhohen si më poshtë:
 - a) marrin përsipër organizimin e vizitave të artistëve pjesëmarrës në pikat historike të qytetit si dhe shfaqje në njësitë rreth tij.
 - b) organizojnë dhe përgatisin forcat më të mira artistike të rrethit në një koncert me numra të zgjedhura i cili hap ose mbyll veprimtarinë kombëtare.
 - c) krijojnë lehtësira organizative Komitetit Organizator, Jurisë dhe gjithë pjesëmarrësve në FFTK.
 - d) marrin përsipër që gjatë ditëve të FFTK të organizojë edhe veprimtari të tjera lokale si: ekspozita të kostumeve popullore, të arteve figurative, të librit, të CD-ve e DVD-ve me këngë popullore, të artizanatit dhe të kulinarisë të cilat janë pjesë integrale e FFTK.

VI. ÇMIMET DHE SHPËRBLIMET

1. FFTK mbyllet me dhënien e çmimeve të cilat shoqërohen me emblemën, kupën apo medaljonin e çdo veprimtarie në veçanti, si dhe shpërblimin për fituesit që shpallen nga Kryetari i Jurisë.

Neni 21

Çmimet

1. Çmimet e FFTK jepen :
 - a) Për interpretuesin/en më të mirë.
 - b) Për grupet popullore më të mira
 - c) Çmimi i Karrierës.
 - d) Çmime inkurajuse për pjesmarrësit e rinj.
2. Çmimet i përshtaten tipologjisë së festivalit.
3. Tre çmimet e para emërtohen me emra të artistëve më në zë të tipologjisë së FFTK dhe të qytetit organizativ.
4. Shpërblimi financiar për çmimet është i njëjtë për çdo çmim edhe në varësi të numrit të grupit që merr çmimin.
5. Emërtimet e çmimeve propozohen nga QKVF dhe miratohen nga Komiteti Organizativ.

Neni 23

Vlerësimi nga juria

1. Vlerësimi nga juria bëhet mbështetur në kriteret e përcaktuara nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe QKVF, të hartuara përpara zhvillimit të FFTK.
2. Numri i çmimeve propozohen nga QKVF dhe miratohen në Komitetin Organizativ.
3. Masa e shpërblimit për fituesit si dhe kupa apo medalioni për ta, caktohet nga Komiteti Organizativ i FFTK.

Neni 24

Shpërblimet

1. Kontributi i anëtarëve të jashtëm të strukturës organizative të FFTK (Komiteti Organizativ, Juria, Komisionet përzgjedhëse), shpërblehen sipas ligjeve në fuqi, brenda buxheteve të miratuara në kuadër të projektit.

Neni 25

Burimet financiare

1. Burimet financiare për zhvillimin e FFTK përbëhen nga:

- a) buxheti vjetor i QKVF i miratuar nga Ministria Kulturës;
- b) buxheti i planifikuar i Bashkisë së qytetit organizator, i sponsorëve dhe donatorëve të ndryshëm, të cilët mund të jenë vendas dhe të huaj
- c) prodhimeve audio, DVD dhe CD të këtyre festivaleve dhe shitjen e të drejtës televizive të FFTK, sipas ligjit 35/20016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me to”

Neni 26

1. Për të gjithë pjesmarrësit në FFTK, QKVF shpërndan certifikata të pjesmarrjes në festival.

VII. TË TJERA

Neni 27

Ndryshimet në Rregullore

1. Përmirësimet apo ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të QKVF dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve të Kulturës në Ministrinë e Kulturës dhe miratohen nga Ministri i Kulturës.

Neni 28

1. QKVF për rritjen e cilësisë së FFTK si dhe promovimit dhe ballafaqimit të vlerave kulturore të vendeve të ndryshme në shkallë vendi dhe rajoni, në dobi të integrimit europian të Shqipërisë, integrimin e qyteteve tona në rrjetin europian të zhvillimit të veprimtarive ndërkombëtare, në dobi edhe të propagandimit të turizmit kombëtar në përgjithësi dhe turizmit kulturor në veçanti, i propozon për miratim Ministrit të Kulturës që ndonjë nga këto festivale të kthehet në Festival Ndërkombëtar.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri i Kulturës.